VENDIM
Nr. 32/2020

PËR NGRITJEN E NËNKOMISIONIT, PËR MONITORIMIN E ZBATIMIT TË BUXHETIT TË SHTETIT DHE KONTROLLIN E TIJ, NË PËRBËRJE TË KOMISIONIT TË PËRHERSHËM PARLAMENTAR PËR EKONOMINË DHE FINANCAT

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 19, pika 2, 21, pika 1, 21/1 dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngrihet Nënkomisioni për Monitorimin e Zbatimit të Buxhetit të Shtetit dhe Kontrollin e tij, në përbërje të Komisionit të Përhershëm Parlamentar për Ekonominë dhe Financat.

II. Fusha e përgjegjësisë së këtij nënkomisioni është mbikëqyrja e zbatimit të buxhetit të shtetit dhe kontrolli e tij.

III. Nënkomisioni përbëhet nga 9 anëtarë të përhershëm, si më poshtë:

1. Ervin Bushati	kryetar	(PS);
2. Edlira Hyseni	zëvendëskryetar	(GP i Pavarur);
3. Anastas Angjeli	anëtar	(PS);
4. Adnor Shameti	anëtar	(PS);
5. Fadil Nasufi	anëtar	(PS);
6. Ardit Konomi	anëtar	(PS);
7. Halil Jakimi	anëtar	(GP Demokrat);
8. Andi Përmeti	anëtar	(Pa grup parlamentar);
9. Edmond Rrushi	anëtar	(GP Demokraci dhe drejtësi).

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 25.6.2020